VENDIM
Nr. 209, datë 9.4.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 858, DATË 29.12.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E TË DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 e 29, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3, e aneksit nr. 3, që i bashkëlidhet vendimit nr. 858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Lista e shteteve, shtetasit e të cilave hyjnë pa vizë për motive turistike në Republikën e Shqipërisë dhe me dokumentin "pasaportë" për një periudhë të kufizuar, nga data 15 prill deri më 31 dhjetor 2025.".

Nr.	Shteti
1	Arabi Saudite
2	Katar
3	Oman
4	Tajlandë
5	Indonezi

2. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku